



Në bazë të nenit 11.3 p.3, nenit 39 të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave Nr.2000/45, nenit 27 pika "m" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 54 të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve nr.028/2002, Rregullores mbi masat dhe lartësinë e kompenzimit për rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës ndërtimore, nr. 0180/2002 të datës 30.05.2002, Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat Komunale, dhe gjobat në disa fusha të veprimtarive nr.042/2002 të datës 26.02.2002, plotsimet dhe ndryshimet e Rregullorës mbi Taksat, Ngarkesat Komunale dhe Gjobat në disa fusha të veprimtarive 01 nr.0182/2002, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur më 27.06.2002 miraton këtë:

RREGULLORE

MBI LICENCIMIM E SUBJEKTEVE AFARISTE

Neni 1

1.1. Çdo person fizik apo juridik në territorin e komunës mund të regjistrojë biznesin në pajtim me Rregulloren 2000/8 mbi regjistrimin e përkohshëm të biznesit në Kosovë.

1.2. Bizneset që angazhohen në zhvillimin e veprimtarisë së ligjshme ekonomike me qëllim fitimprurës janë të obliguar që të bëjnë licencimin e bizneseve të tyre në Komunë, (në bazë të nenit 4 të udhëzimit administrativ nr 2001/2 dhe 2001/3 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45.

Neni 2

Objektet afariste në territorin e komunës mund të shfrytëzohen për kryerjen e veprimtarive afariste dhe aktivitetet e tyre komerciale konform rregullores mbi Licencimin e biznesit.

Neni 3

Për të bërë licencimin e biznesit personi juridik apo fizik është i obliguar që të siguroi këtë dokumentacion:

1. Çertifikatën e biznesit të regjistruar
2. Lejen e ndërtimit – legalizimit të objektit afarist
3. Leje për shfrytëzimin e objektit afarist me karakter të përkohshëm ose të përhershëm
4. Fletën poseduese
5. Kontratën mbi shfrytëzimin e tokës ndërtimore.
6. Kontratën mbi dhënjën dhe marrjen e lokalit me qira
7. Plotësimi i kushteve higjieno – teknike të objektit afarist .
8. Dëshminë se i ka paguar të gjitha obligimet paraprake ndaj buxhetit Komunal.

Neni 4

Pas sigurimit të dokumentacionit, personi fizik apo juridik do të paguaj shumën prej 30 € për licencimin e biznesit.

Neni 5

Obligohen Drejtoria per zhvillim territorial, Drejtoria e inspektionit dhe Drejtoria për ekonomi e financa që me rastin e aplikimit të kësaj Rregulloreje që të zbatojnë rregulloren mbi taksat ngarkesat,dhe gjobat në disa fusha të veprimtarive nr.0042/2002, dhe 0182/2002,si dhe Rregulloren mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve nr.0028/2002 dhe 0180/2002..

Neni 6

Të gjitha bizneset që afarojnë në teritorin e komunes jane të obliguar që në afat prej 3 muajve (nga dita e aprovimit të rregullores) të bëjnë licencimin e bizneseve. Për dhënjen e licencës në teritorin e komunës është përgjegjëse Drejtoria për Ekonomi e Financa- Sektori për zhvillim ekonomik

Neni 7

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullorej do të jenë: Drejtoria për zhvillim territorial, Drejtoria për inspektion, Drejtoria per ekonomi e Financa dhe organet tjera komunale.

Masat ndëshkimore (gjobat)

Neni 8

Me gjobë prej 250 deri në 500 €do të ndëshkohen për kundërvajtje ndërmarrjet dhe personat tjerë

1. Nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 1.al. 2 të kësaj Rregulloreje
2. Nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 2 të kësaj Rregulloreje
3. Nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 3 të kësaj Rregulloreje.

Përkundërvajtje nga neni 6 me gjobë prej 125 deri në 250 Euro do të ndëshkohen personat përgjegjës fizik apo juridik, të cilëve për kundërvajtjet e cekura mund t'ju shqiptohet edhe masa e sigurisë – ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë në teritorin e komunës së Vushtrrisë në kohë zgjatje prej 3 muaj deri në 1 vit.

Neni 9

Kjo rregullore shfuqizon çdo pjesë të rregulloreve të mëparshme që janë në kundërshtim me te.

Neni 10

Kjo rregullore do të hynë në fuqi nga data e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Kryetari i Kuvendit
Muharrem Shabani